- Mospagesa e obligimeve te kontraktuara nga nje pjese e madhe e konsumatoreve të cilët kanë nënshkru kontratë për pagesën e borxheve me kiste (janë dergu mesazhe permes telefonit te konsumatorët qe nuk i permbahen pagesave te kisteve), gjithashtu edhe janë vizituar në teren nga inspektorati ku i janë lëshuar proceverbale për borxhin e kontraktuar e të papaguar.

- Vazhdon problematika e mos zgjidhjes së problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit të kjo kategori e konsumatorëve. Ky numër vazhdon të rritet për çdo muaj dhe konsiderojmë që ky numër në terren është mjaft i madh.
- Pamundësia e leximit të ujëmatëve për çdo muaj të një numër i konsumatorëve, nga inkasatë tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për t'u mundësuar inkasatëve leximin e orëve (kryesisht të konsumatorët që jetojnë në ndërtesa kolektive-banesa).
- Moszgjidhja e qështjes së borxheve të mëhershme, trashëgimi i borxheve në prona.
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

#### **1.4 Masat e realizuara/ mosrealizuara nga periudha paraprake**

- Edhe pse kemi pas rritje të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit si rezultat i legalizimit të konsumatorëve ilegal apo edhe pëlqimeve për kyqje, kemi 230 fatura të shtypura më pak si rezultat i pasivizimit të konsumatorëve të fshatit Hoqë e Qytetit ( rreth 500 konsumatorë) në fund të muajit dhjetor 2018.
- Kemi një inkasim më të vogël në krahasim me tremujorin paraprak, si rezultat i pamundësisë së pagesës nga ana e konsumatorëve. Një ndër arsyt kryesore për rënien e inkasimit për rreth 33. 000 euro në krahasim me muajin paraprak është më tepër sezonale , pasi që në TM4 2018 një numër i konsumatorëve institucional kanë parapaguar faturat e tyre gjatë muajit dhjetor.
- Ekipet e inspektoratit me përmbaruesin privat kanë vizituar rreth 220 raste të konsumatorëve në terren, duke i dorëzuar urdhërin për përmbarim.
- Aktivitete me përmbarues privat (dalja në terren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatorëve, trashëgimtarëve të tyre etj)
- Janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbarimore në terrenet e inkasatëve në qytet .Ku në muajin në vijim, konsumatorët të cilët nuk i paguajn ose nuk bëjnë kontratë për pagesën e borxhit me kiste do të dërgohen tek përmbaruesit privat.
- Janë vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kisteve nga kontratat për pagesën e borxhit me kiste. Te këta konsumatorë janë përpiluar proceverbalet ku janë njoftuar me pasojat që mund të kenë nga mospagesave e obligimeve të kontraktuara.

#### **1.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim**

- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit të konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit të konsumatorët pa ujëmatës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në terren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve të përmbauresi duke i ndërruar terrenet e inkasatëve.
- Vizita më të shpeshta të konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
- Vazhdimësia e mbështetjes së inkasatëve nga ekipi i kontrolles të konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat

- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit.

#### **1.6 Aktivitet për zvoglimin e UPF-se**

##### **-Identifikimi i konsumatorëve ilegal, legalizimi i tyre dhe shkyçja e konsumatorëve problematik (lidhjeve ilegale dhe shfrytëzimit të paautorizuar të ujit);**

Janë identifikuar dhe legalizuar 340 konsumatorë, ndërsa janë identifikuar 7 konsumatorë të cilët kanë shfrytëzuar ujin në mënyrë të paautorizuar ( ilegale)

##### **-Identifikimi dhe procedimi penal i konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujin)**

Gjatë periudhës raportuese në proceduar në gjykatë shtatë konsumatorë të cilët kanë shfrytëzuar ujin në mënyrë të pa autorizuar.

**RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE**  
**TM4-2018 -TM1- 2019**

• NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM4-2018	TM1-2019	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	499,660	553,333	53,673	10.74
<i>Faturimi m3</i>	223,303	193,466	(29,837)	-13.36
<i>Faturiminguaji €</i>	133,338.85 €	133,494.63 €	155.78 €	0.12
<i>Faturimi- tetjere €</i>	1,836.46 €	745.00 €	- 1,091.46 €	-59.43
<i>Faturimi Total €</i>	135,175.31 €	134,239.63 €	- 935.68 €	-0.69
<i>Inkasiminguaji €</i>	136,268.99 €	117,033.41 €	- 19,235.58 €	-14.12
<i>Inkasimi - tetjere €</i>	1,553.30 €	575.19 €	- 978.11 €	-62.97
<i>Inkasimi Total €</i>	137,822.29 €	117,608.60 €	- 20,213.69 €	-14.67
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	7,180	7911	731	10.18
<i>% e inkasimit</i>	102.20	87.67	(14.5)	-14.22
<i>Shpenzimet</i>	114,392.58 €	115,943.62 €	1,551.04 €	1.36
<i>Paqat</i>	58,149.03 €	58,472.96 €	323.93 €	0.56
<i>Rrymaelektrike</i>	33,485.27 €	31,494.23 €	- 1,991.04 €	-5.95
<i>Shpe. e derivateveve</i>	4,148.34 €	2,588.97 €	- 1,559.37 €	-37.59
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	10,875.09 €	13,172.51 €	2,297.42 €	21.13
<i>Miremb, e automjeteve</i>	3,126.62 €	1,861.71 €	- 1,264.91 €	-40.46
<i>Shpen. E taksave</i>	663.00 €	630.00 €	- 33.00 €	-4.98
<i>Kemikalet</i>	83.90 €	320.34 €	236.44 €	281.81
<i>Shpenzimet tjera</i>	3,861.33 €	7,402.90 €	3,541.57 €	91.72
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	276,357	359,867	83,510	30.22
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	55.31	65.04	9.73	
<i>Mbulimioperativ</i>	1.20	1.01	(0.19)	
	<b>23,429.71 €</b>	<b>1,664.98 €</b>		



**KOMENTET :****2.1. AKTIVITET KRYESORE**

- Në raport me TM4 2018, në TM1 2019 kemi rënje të ujit të faturuar në [m<sup>3</sup>] për 29,837 [m<sup>3</sup>] ose 13.36 [%].  
Rënia e faturimit në [m<sup>3</sup>] është pasojë e vështirësive atmosferike për leximin e ujëmatësve, sidomos në muajin e fundit të këtij TM.

**2.2. PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE**

- Përkundër faktit që kemi identifikuar dhe eliminuar shumë rrjedhje në rrjet, sidomos në Reshtan dhe në Shirokë, në rritjen e vazhdueshme të faturimit në [m<sup>3</sup>], negativisht kanë ndikuar edhe humbjet komerciale të cilat po na përcjellin vazhdimisht dhe të cilat janë vështirë të evitueshme për shkak të lidhjeve të ndryshme ilegale, si dhe humbjet eventuale teknike të përkohëshme deri sa të identifikohen dhe evitohen.
- Problem paraqet edhe leximi korrekt i ujëmatësve për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të konsumatorëve, ashtu që inkasantët nuk po arrijnë që të mbulojnë terrenin.

**2.3. MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK**

- Kemi bërë përpjekje që të reduktojmë sa më shumë humbjet teknike dhe komerciale
- Leximi dhe faturimi sa më i saktë i konsumit të ujit .
- Kemi arritur që t'i marrim në menagjim edhe dyfshatra të reja, Greikoc dhe Bukosh.

**2.4. MASAT E PROPOZUARA**

- Reduktimi i sa më shumë humbjeve komerciale
- Leximi dhe faturimi i saktë i konsumit të ujit .
- Mbulimi i terrenit edhe përmes kontrollorëve aty ku nuk arrijnë inkasantët.

**3.1. AKTIVITETET KRYESORE**

- Përgjatë TM1 të vitit 2019 kemi pasur rënje të vogël të faturimit në [€] në raport me TM4 paraprak. Rënja e faturimit në [€] në mes TM4 2018 dhe TM1 2019 është për: 935.68 [€], ose 0.69 [%]. Kjo ka ndodhur si rezultat i rënjes së konsumit në këtë TM të sezonës dimërore dhe eventualisht të leximit jot të saktë të ujëmatësve gjatë TM1-2019 si pasojë e vështirësi të theksuara për shkak të numrit të madh të konsumatorëve në raport me inkasantët.

**3.2. PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE**

- Vështirësi në leximin e ujëmatësve për shkak të një numri të madh të pusetave të pa përshtatshme për lexim.
- Vështirësi në mbulimin e terrenit nga Inkasantët në leximin e rregullt të ujëmatësve, për shkak të numrit të madh të konsumatorëve.

**3.3. MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK**

- Leximi i ujëmatësve
- Shpërndarja e faturave te konsumatorët.
- Shpërndarja e paralajmërimeve për dërgim të lëndëve te Përmbaruesi privat në rast mos pagese nga konsumatorët.
- Dërgimi i lëndëve te përmbaruesi privat.

**3.4. MASAT E PROPOZUARA**

- Inkurajimi i Inkasantëve në leximin sa më korrekt të ujëmatësve
- Ofrimi i përkrahjes edhe nga punonjësit tjerë të njësisë në raste të veqanta kur nuk mund të bëhet leximi vetëm nga Inkasanti.
- Shtimi i numrit të Inkasantëve krahas rritjes së numrit të konsumatorëve dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.

**AKTIVITETET KRYESORE**

- Arkëtimi në [€] në raport me TM4 2018 ka një rënjë prej 20,213.69 [€] ose 14.67 [%]. Rënja e inkasimit në këtë TM ndodhë zakonisht në masë më të madhe për çdo vit për shkak se dy muajt e pare të vitit, pagesat nga konsumatorët janë më të vogla, ndërsa institucionet pothuajse nuk paguajnë fare për shkak të mos alokimit të buxjetit.

**5.1.2. PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE**

- Si zakonisht, problemet kryesore në këtë aspekt janë mos gadishmëria e qytetarëve për të kryerë obligimet ndaj Kompanisë.
- Shpenzimet e taksave në angazhimin e Përmbaruesit për të arkëtuar mjetet.
- Shpenzimet e zakonshme operative për mirëmbajtjen e rrjetit.

**5.1.3. MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK**

- Shërbimi sa më i mirë në furnizimin e rregulltë me ujë.
- Angazhimi i Inkasantëve dhe Kontrollorëve në arkëtimin e mjeteve.
- Shërbimi sa më i mirë në furnizimin e rregulltë me ujë.

**5.1.4. MASAT E PROPOZUARA**

- Shërbimi sa më i mirë në furnizimin e rregulltë me ujë.
- Përkushtimi i vazhdueshëm i Inkasantëve dhe Kontrollës në leximin dhe faturimin sa më korrekt të konsumatorëve si dhe insistimin në arkëtimin e mjeteve.

### 6.1. **AKTIVITETET KRYESORE**

- Treguesit kryesor të Performancës flasin për një përmirësim të ndjeshëm gjatë këtij TM1 2019 në raport me TM4 2018, duke pasur ujin e faturuar dhe pa faturuar si përqindje, kurse norma e arkëtimit e përgjithshme si dhe mbulimin operativ tre mujor kanë pasur një rënje ,megjithatë kemi arritur që t'a ruajmë edhe më tutje performancën pozitive.
- Norma e mbulimit operativ mesatare për TM1 2019 është pozitive pra : 1.01

### 6.2. **PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE**

- Kemi mungesë të punonjësve në arkëtimin e mjeteve në teren për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të konsumatorëve.
- Numri aktual prej shtatë inkasantëve është i detyruar që të mbuloj secili mbi njëmijë konsumatorë, prandaj kemi vështirësi në lexim, faturim dhe arkëtim të mjeteve.

### 6.3. **MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK**

- Angazhimi i të gjithë stafit të njësisë në realizimin e detyrave të punës me sa më shumë përgjegjësi dhe kompetencë, në mënyrë që të përmirësojmë cilësinë e shërbimeve ndaj konsumatorëve.
- T'i reduktojmë shpenzimet operative.
- Të përmirësojmë performancën operative të njësisë.

### 6.4. **MASAT E PROPOZUARA**

- Propozoj rritjen e numrit të Inkasantëve edhe për një punonjës edhe pse i vetdijshtëm për implikimin financiar, mendoj se do t'i mbulonim shpenzimet dhe do të rritej performanca në arkëtimin e mjeteve.

**RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE  
TM4-2018 -TM1- 2019**

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM4-2018	TM1-2019	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	229,929	251,066	21,137	9.19
<i>Faturimi m3</i>	31,999	31,755	(244)	-0.76
<i>Faturiminguaji €</i>	21,069.91 €	23,041.82 €	1,971.91 €	9.36
<i>Faturimi- tetjera €</i>	131.00 €	922.00 €	791.00 €	603.82
<i>Faturimi Total €</i>	21,200.91 €	23,963.82 €	2,762.91 €	13.03
<i>Inkasiminguaji €</i>	24,141.74 €	18,769.53 €	- 5,372.21 €	-22.25
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	331.00 €	345.46 €	14.46 €	4.37
<i>Inkasimi Total €</i>	24,472.74 €	19,114.99 €	- 5,357.75 €	-21.89
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1,462	1,471	9	0.62
<i>% e inkasimit</i>	114.58	81.46	(33.1)	-28.91
<i>Shpenzimet</i>	29,914.67 €	33,644.41 €	3,729.74 €	12.47
<i>Pagat</i>	25,177.63 €	26,494.86 €	1,317.23 €	5.23
<i>Rrymaelektrike</i>	1,784.12 €	2,100.08 €	315.96 €	17.71
<i>Shpe. e derivateveve</i>	227.28 €	191.79 €	- 35.49 €	-15.62
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	572.44 €	2,085.21 €	1,512.77 €	264.27
<i>Miremb. e automjeteve</i>	1,262.14 €	180.25 €	- 1,081.89 €	-85.72
<i>Shpen. E taksave</i>	- €	842.00 €	842.00 €	
<i>Kemikalet</i>	- €	- €	- €	
<i>Shpenzimet tjera</i>	891.06 €	1,750.22 €	859.16 €	96.42
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	197,930	219,311	21,381	10.80
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	86.08	87.35	1.27	
<i>Mbulimioperativ</i>	0.82	0.57	(0.25)	

- 5,441.93 € - 14,529.42 €

## KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATORË

### Aktivitetet kryesore

Furnizimi me ujë –**TM1. – 2019.**

Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këti muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftushëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh. Është pastruar edhe kaugullatori dhe është pastruar rezervuari në fshatin Pllavë.

Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

### Aktivitete lobimi

Edhe ne ket tremujor, kemi patur disa vizita në zyre nga ana e konsumatorëve, ku konsumatorët me shumë kane qene te interesuar per tu informuar rreth leximit të ujëmatësve, dhe per shperndarjen e faturave, por edhe per borgjet e tyre.

### Prodhimi i ujit m3

Gjatë muajit **TM1. 2019.** ka pasur një rritje të sasisë së ujit të prodhuar për 21.137. m<sup>3</sup> në raport me tremujorin paraprak. Sasia e ujit të prodhuar ka arritë në 251.066. m3. Kjo sasi ka mundësuar furnizim të rregullt me ujë për të gjithë konsumatorët. Kjo rritje e prodhimit është si shkak i rritjes së kërkesave për ujë për konsum.

### Uji i faturuar m3

Në **TM1.** janë faturuar 31.755.m<sup>3</sup> ujë, nese e krahasojm me tremuajin paraprak, kemi një rënje në faturim për 244.m<sup>3</sup>. Kjo rënje në faturim, është per faktin se nevojat për konsum kanë qenë më të ulta se në muajt paraprak.

### Aktivitetet kryesore (Ekipa e kontrollës )

Aktivitetet e kontrollës, edhe ne këtë TM. nuk kanë munguar, më shumë kanë qenë të angazhuar në inkasimin e borxheve, ku edhe krahas gjitha angazhimeve nuk ka pas inkasim të mjaftushëm për mbulimin e shpenzimeve. Gjatë këtij muaji ka pasë aktivitete të kontrollës për inkasim dhe keqpërdorim të ujit.

Nr.	Të dhënat	Njësia	TM1.-2019.
1	Ankesat teknike	Nr.	
2	Ankesat komerciale	Nr.	25
3	Njoftime për shkyçje	Nr.	52
4	Shkyçje për mospagesë	Nr.	0
5	Kyçje ilegale	Nr.	0
6	Shkyçje të kyçjeve ilegale -0	Nr.	0
7	Ri- kyçje	Nr.	0
8	Kyçje të reja	Nr.	0
9	Amvisëri	Nr.	0
9	Lokale	Nr.	0
10	Institucione	Nr.	0

11	Procesverbale për mos-pagesë	Nr.	24
12	Verifikim të ujëmatësve	Nr.	0
13	Bllombim te ujëmatësve	Nr.	0
14	Ri- programim te borxhit kontrata	Nr.	24
15	Shuma e kontratës	€.	7.525.10
16	Shuma e inkasuar	€.	892.00
17	Shuma e falur	€.	0

### **Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe**

Si problem kryesor ende na mbetet humbjet e mëdha te ujit , dhe këto humbje janë si pasojë e prishjeve të shumta në rrjetin e ujësjellësit për shkak të vjetërsisë së rrjeti. Inkasimi i borxheve te mëdha te konsumatorët me gjendje jo të mirë ekonomike.

Problemi i mungesës se automjeteve për teren, po ashtu është problem i madh në realizimin e synimeve tona e që janë, eliminimi i humbjeve të ujit si dhe inkasimi më i mirë i mjeteve. Në muajin Mars të kësaj periudhe me shpërndarjen e njoftimeve se do të ndërpritet inkasimi në teren nga 01.04.2019. inksasantët janë ankuar se edhe disa klient të rregullt në pagesa nuk kanë paguar me arsyetim se do të vin të paguajn në arkën e Njësisë.

### **Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake/**

Është berë leximi i ujëmatësve me kohë.

Janë shpërndarë me kohë faturat te të gjithë konsumatorët

Shqyrtimi me kohë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve.

### **2.4 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim**

Leximi sa më i saktë i ujëmatësve nga ana e lexuesve

Shpërndarja me kohë e faturave tek të gjithë konsumatorët

Insistimi që të zvogëlojmë humbjet e ujit

Zbulimi i sa me shumë lidhjeve ilegale ne rrjetin e ujësjellësit,

Sigurimi i automjeteve per pune në terenë, për ekipet e kontrollës dhe inkasantë.

**RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE  
TM4-2018 -TM1- 2019**

• NJËSIA PUNUESE - MALISHEVË

MUAJI	TM4-2018	TM1-2019	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	356,952	361,284	4,332	1.21
<i>Faturimi m3</i>	156,480	141,874	(14,606)	-9.33
<i>Faturiminguaji €</i>	99,093.02 €	101,313.51 €	2,220.49 €	2.24
<i>Faturimi- tetjera €</i>	10,578.19 €	1,706.85 €	- 8,871.34 €	-83.86
<i>Faturimi Total €</i>	109,671.21 €	103,020.36 €	- 6,650.85 €	-6.06
<i>Inkasiminguaji €</i>	111,480.16 €	95,365.20 €	- 16,114.96 €	-14.46
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	4,929.15 €	7,849.45 €	2,920.30 €	59.25
<i>Inkasimi Total €</i>	116,409.31 €	103,214.65 €	- 13,194.66 €	-11.33
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	5,497	5,518	21	0.38
<i>% e inkasimit</i>	112.50	94.13	(18.4)	
<i>Shpenzimet</i>	91,285.29 €	93,119.53 €	1,834.24 €	2.01
<i>Paqat</i>	51,693.35 €	52,029.82 €	336.47 €	0.65
<i>Rrymaelektrike</i>	27,934.50 €	28,036.91 €	102.41 €	0.37
<i>Shpe. e derivateveve</i>	2,224.21 €	1,409.34 €	- 814.87 €	-36.64
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	4,154.82 €	4,689.91 €	535.09 €	12.88
<i>Miremb, e automjeteve</i>	1,665.20 €	957.71 €	- 707.49 €	-42.49
<i>Shpen. E taksave</i>	609.87 €	736.74 €	126.87 €	20.80
<i>Kemikalet</i>	266.91 €	435.34 €	168.43 €	
<i>Shpenzimet tjera</i>	2,736.43 €	4,823.76 €	2,087.33 €	76.28
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	200,472	219,410	18,938	9.45
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	56.16	60.73	4.57	
<i>Mbulimioperativ</i>	1.28	1.11	(0.17)	
	<b>25,124.02 €</b>	<b>10,095.12 €</b>		

## II . KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATORË-TM1

### 2.1 Aktivitetet kryesore –TM1/2019

Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë në TM1/2019, marre ne përgjithësi ka qenë shumë më i mirë, sikurse ne TM4/2018, problem me furnizim te plote me ujë ne TM1, kemi pasur vetëm ne muajin mars për konsumatorët e fshatit Bellanicë, Lladroc për shkak te zvogëlimit te ujit ne burime.

### Prodhimi i ujit m3-TM1

Prodhimi i ujit m<sup>3</sup> - në TM1/2019 ka qenë 361,284 m<sup>3</sup>, qe krahasuar me TM4/2018 që ishte 356,952 m<sup>3</sup>, ka një ngritje të lehtë prej 4,332 m<sup>3</sup>ose 1.21 %. Kjo rritje e prodhimit është cekur me lartë.

### Uji i faturuar m3-TM1

Faturimi i ujit në m<sup>3</sup> në TM1/2019 është 141,874 m<sup>3</sup>,krahasuar me TM4/2018 (156,480 m<sup>3</sup>),ne ketë tremujor është ulur për 14,606 m<sup>3</sup> ose -9.33 %. Kjo ulje e faturimit është bërë për arsye se në këtë tremujor nuk jemi duke i faturuar konsumatorët e fshatrave Terpezë dhe Ngucat, si dhe ka ndikuar edhe pushimet e institucioneve shkollore.

### 2.1 Aktivitetet kryesore-TM1/2019 (Ekipa e kontrollës )

Edhe ne TM1 , aktivitetet kryesore të ekip kontrollës kanë qenë angazhimi në inkasimin e borxheve të mëdha,shpërndarja e vërejtjeve për mos pagesë te borxheve,njoftime për shkyçje, verifikim te ujëmatësve si dhe aktivitete te tjera te cilat i kemi paraqitur ne tabela.

Nr.	Të dhënat	Njësia	TM4/2018	TM1/2019
1	Ankesat teknike	Nr.	29	28
2	Ankesat komerciale	Nr.	13	35
3	Njoftime për shkyçje	Nr.	145	173
4	Shkyçje për mospagesë	Nr.	18	0
5	Kyçje ilegale	Nr.	3	0
6	Shkyçje të kyçjeve ilegale -0	Nr.	6	0
7	Ri- kyçje	Nr.	13	0
8	Kyçje të reja	Nr.	55	25
9	Amvisëri	Nr.	52	16
9	Lokale	Nr.	3	9
10	Institucione	Nr.	0	0
11	Procesverbale për mos-pagesë	Nr.	82	64
12	Verifikim të ujëmatësve	Nr.	373	189
13	Bllombim te ujëmatësve	Nr.	247	87
14	Ri- programim te borxhit kontrata	Nr	7	8
15	Shuma e kontratës	€		
16	Shuma e inkasuar	€		
17	Shuma e falur	€		



## 2.2 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe-TM1/2019

- Edhe ne periudhën e TM1/2019 , kemi hasur ne probleme te njëjta si ne periudhën e TM4/2018,prapë si problem kryesor ende na mbetet humbjet e mëdha te ujit , dhe këto humbje janë si pasojë e prishjeve të shumta në rrjetin e ujësjellësit,por edhe si pasojë e vjedhjeve nga ana e konsumatorëve të pa përgjegjshëm.
- Inkasimi i borxheve te mëdha te konsumatorët me gjendje jo të mirë ekonomike.
- Mos leximi i mirë i ujëmatësve për arsye te kushteve atmosferike
- Problemi i mungesës se automjeteve për teren, po ashtu është problem i madh në realizimin e synimeve tona e që janë, eliminimi i humbjeve të ujit si dhe inkasimi më i mirë i mjeteve.

## 2.3 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake-TM4

Edhe ne TM1/2019 , shumica e planeve te përcaktuara janë realizuar me sukses dhe me kohe, siç janë:

Janë shpërndarë me kohë faturat te të gjithë konsumatorët

Inkasimi ne amvisëri dhe ne biznese ka qen i mirë, dhe te institucionet.

Kemi dërguar 36 lëndë te përmbaruesi privat.

## 2.4 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

Për periudhën ne vazhdim-TM1/2019 kemi këto masa:

Leximi sa më i saktë i ujëmatësve nga ana e lexuesve

Shpërndarja me kohë e faturave tek të gjithë konsumatorët

Zbulimi i sa me shumë lidhjeve ilegale ne rrjetin e ujësjellësit

Insistimi që të zvogëlojmë humbjet e ujit

Dërgimi i mbi 15 lëndëve te përmbaruesi privat

Vetëdijësimi i sa me shumë konsumatorve për ti shlyer obligimet e tyre ndaj kompanisë

### TM4-2018 -TM1- 2019

• **HIDROREGJIONI JUGOR**

MUAJI	TM4-2018	TM1-2019	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	4,123,241	3,637,883	(485,358)	(11.77)
<i>Prodhimi - l/sec</i>	1,591	1,358	(232.53)	(14.62)
<i>Faturimi m3</i>	1,796,648	1,592,825	(203,823)	(11.34)
<i>Faturimi l/sec</i>	693	595	(98.5)	(14.20)
<i>Faturiminguaji €</i>	1,068,315.09 €	1,076,458.21 €	8,143.12 €	0.76
<i>Faturimi- tetjera €</i>	22,457.46 €	14,390.75 €	- 8,066.71 €	(35.92)
<i>Faturimi Total €</i>	1,090,772.55 €	1,090,848.96 €	76.41 €	0.01
<i>Inkasiminguaji €</i>	1,146,366.13 €	1,071,330.22 €	- 75,035.91 €	(6.55)
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	11,834.43 €	14,952.45 €	3,118.02 €	26.35
<i>Inkasimi Total €</i>	1,158,200.56 €	1,086,282.67 €	- 71,917.89 €	(6.21)
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	48,591	49,122	531	1.09
<i>% e inkasimit</i>	107.31	99.52	(7.78)	
<i>Shpenzimet</i>	982,493.68 €	964,465.14 €	- 18,028.54 €	(1.83)
<i>Pagat</i>	548,598.74 €	560,048.82 €	11,450.08 €	2.09
<i>Rrymaelektrike</i>	216,732.08 €	228,736.87 €	12,004.79 €	5.54
<i>Shpe. e derivateveve</i>	28,764.23 €	21,582.28 €	- 7,181.95 €	(24.97)
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	74,205.85 €	49,741.73 €	- 24,464.12 €	(32.97)
<i>Miremb. e automjeteve</i>	19,469.80 €	13,306.31 €	- 6,163.49 €	(31.66)
<i>Shpen. E taksave</i>	23,405.82 €	27,645.44 €	4,239.62 €	18.11
<i>Kemikalet</i>	4,111.41 €	2,412.53 €	- 1,698.88 €	(41.32)
<i>Shpenzimet tjera</i>	67,205.75 €	60,991.16 €	- 6,214.59 €	(9.25)
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,326,593	2,045,058	(281,535)	(12.10)
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	56.43	56.22	(0.21)	(0.37)
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	897.61	763.54	-0.04	
<i>Mbulimioperativ</i>	1.18	1.13	-0.05	
	<b>175,706.88 €</b>	<b>121,817.53 €</b>		

## I. KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATOR

### 1. Aktivitetet kryesore

- Është bërë leximi i ujëmatësve nga inkasantët (lexuesit) e terenit .
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku janë shpërnda faturat dhe është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit .
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	434
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	434
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	233
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	233
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	233

- Janë vizituar nga ekipet e kontrollës konsumatorët për mospagesë të shërbimeve të ujësjellsit, të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të mëdha ndaj KRU " Hidroregjioni Jugor" sha. Secilit konsumatorë të vizituar nga ekipet e kontrolles i është lënë procesverbali ku ceket borxhi dhe afati për pagesën e borxhit.
- Janë bërë kontrole në teren te konsumatorët nga ekipet e kontrollës edhe për shqyrtim të ankesave të konsumatorëve dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.

### RAPORT I EKIPEVE TË INSPEKTORATIT – TM1 2019

Njesia Operative	Lidhjet e reja/legalizime	Shkyçjet	Lidhje jasht orës	Vërejtje për borxhe/përmbarim	Verifikimi i ujëmatësve
Prizren	340	7	7	2,856	632
Suharekë	15	0	0	798	995
Malishevë	25	0	0	147	189
Dragash	0	0	0	24	0
KRU "Hidroregjioni Jugor"	380	7	7	3,825	1,816

### 2. Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe

- Vazhdon mos zgjidhja e problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve.
- Pamundësia e leximit të ujëmatësve për çdo muaj te një numër i konsumatorëve, nga inkasantët tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për t'iu mundësuar inkasantëve leximin e orëve (kryesisht te konsumatorët që jetojn në ndërtesa kolektive-banesa).
- Moszgjidhja e qeshtjes se borxheve te meherhshme, trashëgimi i borxheve ne prona të konsumatorëve
- Problemet e vazhdueshme me softver nga pamundësia e gjenerimit të raporteve sipas kërkesave tona.

- Faturat e medha mujore te disa konsumatoreve si rezultat e rrjedhjeve mbrenda ujëmatësit dhe pamundësia e pagesës së tyre
- Mosgjdhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

### 3.Masat e realizuara/ mosrealizuara nga periudha paraprake

- Rritje të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit si rezultat i legalizimit të konsumatorëve ilegal apo edhe pëlqimeve për kyqje.
- Rënie e konsumit si rezultat i rënies së konsumit sezonal
- Rënie në inkasim si rezultat I sezonës.

### 1.7 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit te konsumatorët pa ujëmatës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbauresi duke i ndërruar terenët e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
- Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat
- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit.

## RAPORT TREMUJOR I AKTIVITETEVE TË ZYRËS SË INFORMIMIT JANAR, SHKURT , MARS

Nr.	Mediat	Përshkrimi aktivitetit	Nr. Protkollit	Vërejtje
1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	Njoftim për konsumatorët në Prizren , se në lokacioni Euro Center rruges per spital për shkak të defektit në gypin transportues FI 160 mm do të kemi probleme me furnizim te ujit në tetë lagje.	58 /11.01.2019	
2	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët në lagjen Kurill tek Ambullanta për shkak të defektit në gypin Transportues FI 300 mm, prandaj do të ketë probleme në Tri lagje të Prizrenit : Lgija Kurilla , Bazhdarana dhe Dardania .	255 / 04.02.2019	

3	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët se është shkaktuar defekt në gypin transportues fi 200 mm tek Xamia e Terzi Mahalles prandaj do të ket ndërprerje te furnizimit me uje të pijes në katër lagje .	280 / 06.02.2019	
3	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët se me daten 12.02.2019 konform njoftimit nga kompania KEDS për ndërprerje të energjisë elektrike si rezultat i punimeve të planifikuara , do të ketë ndërprerje të furnizimit me uje të pijes në Stacionin e pompave tek 40 Burimet .	347/ 12.02.2019	
4	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët e Prizrenit se njoftimi i publikuar me daten 22.02.2019 për ndërprerjen e ujit me daten 25.02.2019 për shkak të kushteve atmosferike punimet shtyhen për daten 26.02.2019 që do të zhvillohen brenda lokacionit 40 Burimet në kuadër të projektit Ndertimi i gypsjellesit kryesor për qytetin e Prizrenit .	488/25.02.2019	
5	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> <li>• Radio Malisheva</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët se njoftimi për daten 25.02.2019 do të zhvillohen punimet në lokacionin 40 Burimet në kuadër të projektit ” Ndertimi i gypsjellesit kryesor për qytetin e Prizrenit” si rezultat i ketyre punimeve do behet pjesërisht ndërprerja e disa burimeve të ujit dhe me këtë edhe pakësimi i furnizimit të mjaftueshem me ujë të pijes.	489/25.02.2019	
6	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> <li>• Të gjitha portalet online</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët nga kompania se nga data 05.03.2019 është hapur arka për pagesa në fshatin Gjonaj në menyrë që konsumatorët e Hasit do të kenë më lehtë të bëjnë pagesat e faturave përmes kësaj arke.	624/05.03.2019	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët se me daten 07.03.2019 ka filluar rehabilitimi i rrjetit në rrugën e Sanxhakut në Prizren.	641/07.03.2019	

7	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>			
8	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Radio Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët se duke filluar nga data <b>01 Prill 2019</b> , pagesat e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza mund ti bëni në arkat për pagesa të kompanisë tonë, Banka komerciale.	640/07.03.2019	
9	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët njofton konsumatorët, se me datën 12.03.2019 ka pasur defekt në lokacionin Andrra rrugës për Prevall në gypin transportues fi 600 mm dhe pa ujë kanë mbetur disa lagje të Prizrenit	673/12.03.2019	
10	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Radio Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët se konform njoftimit nga KEDS - i për nderprerje të energjisë elektrike si rezultat i punimeve te planifikuara do të paraqitet problemi me furnizim me ujë të pijes me datën <b>14.03.2019 duke filluar nga ora 11:00</b> dhe pa ujë do të mbesin disa zona.	692/14.03.2018	
11	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Rado Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> </ul>	<b>Njoftim</b> për konsumatorët , se me datën <b>19.03.2019 duke filluar nga ora 10:00 deri në orën 17:00</b> për shkak të punimeve në gypin transportues Fi 600 mm tek lokacioni 40 Burimet, pa furnizim të ujit do të mbesin disa zona	711/18.03.2019	
12	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tv.Prizreni,</li> <li>• TV Besa,</li> <li>• TV Opinion,</li> <li>• Radio Helix,</li> <li>• Radio Omega 3,</li> <li>• Levent Kasëmi</li> <li>• Te gjitha portalet e vendit</li> </ul>	Njoftim per konsumatoret per shkyqje	1129/29.03.2019	

## II. KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR FINANCIAR

- ***Aktivitetet e nga departamenti financiar për TM1-2019***

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

- Mbyllja salldove të vitit 2018 dhe hapja e salldove të vitit fiskal 2019;
- Regjistrimi i depovo, arkave dhe regjistrimit të inventarit, sipas ligjeve në fuqi;
- Regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe asetëve për muajt përkatës.
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Prgatitja e raporteve mujore, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe prgatitja e pagave për muajtë përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punsuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve;
- Plotesimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas formës standarte të kërkuar nga ATK, për muajtë përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;

### **Arsyeshmëria e shpenzimeve**

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e I-rë 2019, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të IV-të 2018, janë më të ulëta, por edhe performanca është e kënaqshme, falë inkasimit dhe angazhimit më të lartë.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo uljes së tyre;

Pozicioni i shpenzimeve të pagave, në këtë pozicion, kemi një rritje të shpenzimeve. Sipas vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv, këtë muaj kemi rritje të vlerës së koeficientit të pagave, andaj si rezultat i

kësaj kemi rritje në këtë pozicion, në krahasim me tremujorin e kaluar. Edhe pse ky pozicion nuk ka ndikuar shumë në shpenzimet totale;

Edhe pozicioni i energjisë elektrike, kemi rritje të shpenzimeve totale në krahasim me tremujorin e IV-të, për shkak se kemi shtim edhe të konsumatorëve edhe pika të reja të burimeve;

Por, te pozicioni i derivateve kemi një rënje të shpenzimeve, tek të gjitha njësitë ka lëvizje të këtyre shpenzimeve, pasi që angazhimi ka qenë më i vogël, duke ditur se sezoni i dimrit nuk ka ndonjë angazhim të madh;

Edhe te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi një rënje. Pra angazhimi në rrjet edhe në mirëmbajtje ka qenë më i vogël për shkak të ngricave, Ky është edhe një nga pozicionet që ka bërë ndryshimin apo uljen e shpenzimeve totale, në krahasim me tremujorin e kaluar të vitit të kaluar;

Rënje kemi edhe te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve të këtyre shpenzimeve, pasi mirëmbajtja e tyre ka qenë më pak e nevojshme në këtë tremujor;

Shpenzimet e taksave janë pothuajse të njejta, me tremujorin e kaluar, me një rritje të lehtë, pasi që shpenzimet për taksat e përmbaruesit kanë qenë më të larta me tremujorin e kaluar, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njejta;

Shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, etj, kemi një rënje të lehtë të këtyre shpenzimeve;

Pra si përfundim, shpenzimet për këtë tremujor kanë qenë më të ulëta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura më lartë, pra pozicioni i pagave dhe energjisë elektrike është më i lartë, për arsyet e cekura më lartë, por që performanca edhe në këtë tremujor është e mirë;

## RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE REALIZIMI - PB -TM1- 2019

### • HIDROREGJIONI JUGOR

MUAJI	PB- TM1-2019	TM1-2019	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,776,620	3,637,883	(138,737)	-3.67
<i>Faturimi m3</i>	1,558,287	1,592,825	34,538	2.22
<i>Faturimi Total €</i>	1,343,298.75 €	1,090,848.96 €	- 252,449.79 €	-18.79
<i>Inkasimi Total €</i>	1,194,401.48 €	1,086,282.67 €	- 108,118.81 €	-9.05
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	48,126	49,122	996	2.07
<i>% e inkasimit</i>	88.91	99.52	10.6	11.93
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	54.00	56.20	2.20	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.24	1.13	(0.11)	



## **Shërbimet e përbashkëta në Departamentin e administratës:**

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marruar me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Në kuadër të raportit të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë janë përfshirë edhe raportet e sektorëve të departamentit të administratës si raporti i punës së zyrës ligjore, i resurseve njerëzore, zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë, aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës si dhe raporti i punës së zyrës së teknologjisë informative për janar - mars 2019.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv. Për Vendimet dhe Rekomandimet e dala në takimet e BtD dhe Komisionit të Auditimit janë njoftuar të gjithë zyrtarët dhe udhëheqësit e Kompanisë pas përfundimit të procesverbalit të takimit përkatës.
- Nga zyra ligjore është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbaruesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.
- Janë harmonizuar kontratat e punës së punëtorëve të Kompanisë sipas Vendimit për rritjen e vlerës së koeficientit nga 75 euro në 85 euro për të gjithë të punësuarit në KRU "Hidroregjioni Jugor" si dhe Vendimit për nivelizimin i koeficienteve të një kategorie të punonjësve në Kompani.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu në shërbim të administratës janë lëshuar për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Vlerësimet të kryerjes së detyrave të punës për punonjësit e KRU gjatë vitit 2018 janë regjistruar në program gjatë këtyre tre muajve nga Zyrtarja për burime njerëzore.
- Janë bere vazhdimet te kontratave te punëtorëve te Kompanisë te cilët kane qene ne afat për gjashte muaj dhe një vite, dhe te punëtorëve qe kanë pasur kontratën e pare te punës me mundësi te vazhdimet, pas vlerësimit të kryerjes se detyrave te punës të bere nga ana e udhëheqësve te sektorëve .
- Është bërë ndërprerje e kontratës së punës punëtorit F.TH –Inspektor- Kontrollor , nga data 05.03.2019 për shkak të mos lajmërimit dhe mungesës në punë më tepër se 5 ditë pune pandërprerë, edhe përkundër përpjekjeve nga Udhëheqësi i njësisë së Malishevës të kontaktoj me telefon punonjësi në fjalë nuk është përgjigjur dhe se nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë. Duke mos i arsyetuar ditët e mungesës nga puna punëmarrësi sipas Rregullores mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A në Prizren, neni 5 paragrafi 22 sjelljen e tillë të punëmarrësit e parasheh si shkelje të rëndë të detyrave të punës.
- Mbështetur në rregulloren e brendshme të Kompanisë "Rregullore mbi orarin e punës te punonjësve" Neni 22 paragrafi 3, punëtorit të njësisë punuese të Prizrenit Adem Rexha i sistemuar me punë dhe detyra të punës Mirëmbajtës i objektit dhe ngrohjes qendrore i

është Lejuar shfrytëzimi i pushim mjekësor me kompensim prej 70% të pagës së tij, dhe atë duke filluar prej datës 05.02.2019 deri më 02.08.2019.

- Sipas kërkesës së Drejtorisë së shërbimeve publike të Komunës së Prizrenit i është dërguar raport që përfshinë numrin e punëtorëve për vitin 2018 sipas nacionalitetit, gjinisë, njësive punuese si dhe numrin e punonjësve më aftësi të kufizuar.
- Është përgatitur Libri lidhës për Qeverisjen Korporatave për vitin 2018 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : certifikatën e regjistrimit të Biznesit,Vendimin mbi emërimin e Bordit,procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për 2018,vendimet e Bordit për 2018,procesverbalet e Komisionit të Auditimit, deklarata e politikës së kompensimit,Vendimet mbi themelimin e komiteteve tjera të Bordit ,procesverbalet e komiteteve, plan-biznesi 2018 , raporti vjetor 2018 dhe raportin mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2018 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit lidhur me aktivitetet e Departamentit gjatë vitit 2018.
- Në MZHE janë dërguar dokumentet e kërkuara për kompletim të ueb faqes së MZHE për vitin 2017. Dokumentet e dërguara në formë elektronike, të skanuara, të nënshkuara dhe të vërtetuara me vulën e Kompanisë janë: Struktura Organizative – Organogrami 2017, Pagat e zyrtareve të lartë për vitin 2017, lista me 10 furnizuesit më të mëdhenj për nga vlera për vitin 2017,Te gjitha Kontratat e Prokurimit me vlera të mëdha për vitin 2017, të gjitha Rregulloret e miratuara nga Bordi i Drejtorëve për vitin 2017, të gjitha dokumentet me rendësi të miratuara nga BD për vitin 2017 si dhe Konfirmim nga Kryesuesi i BD se nuk ka Konflikt të Interesit tek anëtarët tjerë të BD.
- Është dërguar në NJPMNP-MZHE lista e punonjësve të Kompanisë duke përfshirë pozitën e punës, koeficientin dhe pagën e punonjësve për vitin 2019 dhe tabelori me emrat e zyrtarëve të lartë të Kompanisë, datën e emërimit dhe kohëzgjatjen e kontratës së punës.

Nr	Llojet e pushimeve që janë shfrytëzuar nga punonjësit	Nr.i punonjësve
1	Pushim vjetor	127
2	Pushim mjekësor	24
3	Pushim pa pagës	4
4	Pushim lehonisë	1
5	Pushim për lindje të fëmijut	2
6	Pushimi mjekësor 70%	1

**Konkurset: Janar – Mars -2019**

Gjate këtyre tre muajve janë shpallur gjashte konkurse një rishpallje e konkursit, pas konfirmimit me shkrim nga shërbimi i financave që Kompania ka buxhet për hapje të secilit konkurs veç e veç :

Nr	Pozita e punës	Nr i kryesve	Dita e shpalljes se konkursit	Njesija
1	Përgjegjës i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit	1	16.01.2019	Malishevë
2	Rojtar	1	17.01.2019	Dragash
3	Vozitës I mjeteve (MLT)- Rojtar	1	17.01.2019	Dragash
4	Inkasant	1	31.01.2019	Prizren-rishpallje
5	Rishpallje Inkasant	1	08.03.2019	Prizren
6	Punëtor fizik ITUZ	3	29.03.2019	Prizren
7	Teknik i/e Laboratorit ITUZ	1	29.03.2019	Prizren

**PERSONELI – JANAR– MARS 2019**

Muajt	Nr.i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	327	3			
Shkurt	327				
Mars	329	2	1		

**NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: MARS 2019**

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	283	34	5	7	329
Numri i Punëtorëve në %	86.0	10.3	1.5	2.1	<b>100</b>

**NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË**

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	42	12.77	
MESHKUJ:	287	87.23	
TOTAL	329	100	

## KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: MARS 2019

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A							
KUALIFIKIMI							
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punëtorëve	<b>34</b>	<b>41</b>	<b>1</b>	<b>206</b>	<b>46</b>	<b>1</b>	<b>329</b>
Kualifikimi në %	<b>10.33</b>	<b>12.46</b>	<b>0.30</b>	<b>62.61</b>	<b>13.98</b>	<b>0.30</b>	100

## Raport i numrit te punëtorëve përfshire edhe Bordin për Janar- Mars – 2019

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	Prak.	Total			
1	Janar	<b>333</b>	238	6	8	<b>244</b>	<b>37</b>	<b>16</b>	<b>36</b>
2	Shkurt	<b>333</b>	238	6	8	<b>244</b>	<b>37</b>	<b>16</b>	<b>36</b>
3	Mars	<b>335</b>	238	6	8	<b>244</b>	<b>37</b>	<b>18</b>	<b>36</b>

## PËRFAQËSIMI NË GJYKATA DHE ARDHJA NË TOTAL E LËNDVE NGA GJYKATAT PËR PERIUdhËN KOHORE JANAR - MARS 2019

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Shkresat e ardhura nga gjykatat
<b>Janar</b>	/	<b>1</b>	/	<b>21</b>
<b>Shkurt</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	/	<b>25</b>
<b>Mars</b>	<b>4</b>	/	/	<b>11</b>
<b>Totali</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	/	<b>87</b>

Siç edhe shihet në tabelën lart, në këtë periudhë kohore kemi marrë pjesë në gjithsej **7 (shtatë)** seanca gjyqësore prej të cilave **5 (pesë)** seanca kanë qenë përgatitore, dhe, **2 (dy)** seanca kryesore.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, në Zyrën Ligjore nga Gjykatat kanë ardhur këto shkresa, ku:

- **Për 9 (nëntë)** lëndë nga gjykatat janë marrë Vendime në favor të kompanisë;
- **Për 4 (katër)** lëndë nga gjykatat janë marrë Vendime kundër kompanisë;
- **Për 20 (njëzet)** lëndë gjykatat kanë aprovuar pjesërisht Prapësimet e konsumatorëve;
- **8 (tetë)** Konkluzione të ndryshme;

- **3 (tri)** Aktvendime me të cilat gjykata cakton përfaqësues të përkohshëm;
- **5 (pesë)** Thirrje për seanca gjyqësore;
- **4 (katër)** Ankesa në Gjykatën e Apelit;
- **1 (një)** Përgjigje në Ankesë në Gjykatën e Apelit
- **3 (tri)** Urdhëresa për pagesë të garancisë;
- **1 (një)** Aktvendim i hedhur poshtë si jo i plotë-anulohet-lihet jashtë fuqie;

### PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT

#### JANAR – MARS 2019 NJËSIA PUNUESE PRIZREN

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Janar	/	8	8	10	/	14
Shkurt	106	13	13	7	1	4
Mars	104	15	15	8	1	5
<b>Totali</b>	<b>210</b>	<b>36</b>	<b>36</b>	<b>25</b>	<b>2</b>	<b>23</b>

Nga Njësia Punuese e Prizrenit me Përmbarduesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **210 (dyqindtë e dhjetë)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **36 (tridhjetë e gjashtë)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **36 (tridhjetë e gjashtë)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **25 (njëzet e pesë)** marrëveshje me debitorë.
- 2 (dy) lëndë të tërhequra.
- Janë përfunduar **23 (njëzetë e tri)** lëndë.

#### JANAR – MARS 2019 NJËSIA PUNUESE MALISHEVË

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Janar	/	/	/	3	/	4
Shkurt	/	/	/	/	/	1
Mars	36	1	1	7	/	3
<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>/</b>	<b>8</b>

Nga Njësia Punuese e Malishevës me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **36 (tridhjetë e gjashtë)** lëndë me propozim për përmbauesim.
- Nga konsumatorët është parashtruar **1 (një)** prapësime.
- Nga kompania është dhënë **1 (një)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **10 (dhjetë)** marrëveshje me debitorë.
- Nuk ka pasur lëndë të tërhequra.
- Janë përfunduar **8 (tetë)** lëndë.

#### JANAR – MARS 2019 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË

	Propozime për përmbauesim	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Janar	13	/	/	/	/	1
Shkurt	/	/	/	3	/	1
Mars	10	1	1	/	/	3
<b>Totali</b>	<b>23</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>/</b>	<b>5</b>

Nga Njësia Punuese e Suharekës me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **23 (njëzetë e tre)** lëndë me propozim për përmbauesim.
- Nga konsumatorët është parashtruar **1 (një)** prapësime.
- Nga kompania është dhënë **1 (një)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **3 (tri)** marrëveshje me debitorë.
- Nuk ka pasur lëndë të tërhequra.
- Janë përfunduar **5 (pesë)** lëndë.

#### JANAR – MARS 2019 NJËSIA PUNUESE DRAGASH

	Propozime për përmbauesim	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Janar	15	/	/	1	/	1
Shkurt	11	/	/	1	/	2
Mars	6	4	4	4	/	1
<b>Totali</b>	<b>32</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>/</b>	<b>4</b>

Nga Njësia Punuese e Dragashit me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **32 (tridhjetë e dy)** lëndë me propozim për përmbauesim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **4 (katër)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **4 (katër)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **6 (gjashtë)** marrëveshje me debitorë .

- Nuk ka pasur as tërheqje të ndonjë lënde.
- Janë përfunduar **4 (katër)** lëndë.

#### LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

<b>Nr.</b>	<b>C.nr.</b>	<b>Kontesti</b>	<b>Vlera</b>	<b>Vërejtje</b>
<b>1.</b>	<b>C.nr. 1214/12, datë 05.03.2013</b>	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Ende e pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
<b>2.</b>	<b>C. nr. 116/03, datë 08.05.2013</b>	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
<b>3.</b>	<b>C.nr. 286/14, datë 03.06.2015</b>	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
<b>4.</b>	<b>A.nr. 420/2015, datë 03.04.2017</b>	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Kontest administrativ	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
<b>5.</b>	<b>C.nr. 170/18, datë 14.09.2018</b>	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 1,170.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
<b>6.</b>	<b>C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017</b>	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 3200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
<b>7.</b>	<b>C.nr. 416/18, datë 24.05.2018</b>	Padi – Kontest pronësor	Vlera e kontestit 500 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
<b>8.</b>	<b>C.nr. 99/16, datë 06.03.2018</b>	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 10,000 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
<b>9.</b>	<b>C.nr. 364/16, datë 12.10.2016</b>	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 3200 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
<b>10.</b>	<b>C.nr.1173/18, datë 10.09.2018</b>	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Vlera e kontestit 3500 €	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë

### **Aktivitetet e TM-1/2019 të Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë**

Gjatë TM-1 të vitit 2019 janë realizuar vizitat e objekteve të Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, janë kontrolluar të gjitha objektet në njesin e Prizrenit, siq janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatorët”, objektet te “Mulliri i vjetër”, objektet dhe burimet e “40 Burimet”, objekti dhe “40 Burimeve - II “ ku është kontrolluar gjendja e tyre, pastërtia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapësira për rreth objekteve, si dhe është bërë kontrollimi i aparateve kundër zjarrit dhe gjendja e tyre.

Në këtë periudhë të tremujorit së bashku me zyrën ligjore kemi kontrolluar draft planin e reagimit emergjent dhe kemi akorduar se ky draft plan të dërgohet në Bordin e Drejtorëve për të marrë aprovimin dhe të nënshkruhet nga kryesuesi i bordit dhe të shpërndahet edhe njësive punuese për rastet emergjente.

Gjatë kësaj periudhe janë vizituar stacionin e pompave në Vermic, si dhe stacioni i pompave në Zhur ku janë kontrolluar mirëmbajtja e objektit dhe hapësira për rreth objektit.

Gjatë TM/1 janë vizituar stacionin e pompave në Nashec janë kontrolluar objekti dhe hapësira për rreth objektit, është vlerësuar se mirëmbajtja e objektit dhe hapësirës për rreth objektit është në gjendje të kënaqshme.

Gjatë këtij tremujori janë bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operativ për kujdesin në punë dhe respektimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duke realizuar punime në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit nëpër disa vende të ndryshme në qytetin e Prizrenit.

### **Aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administratori i Rojës për TM/1, 2019 – Prizren**

Gjatë tremujorit të parë janë realizuar vizita/kontrolla të vazhdueshme mbrenda dhe jashtë orarit në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje 24 h në pikat e Prizrenit: 40 burimet, Mulliri i vjetër, Shpati, Bunari 1, Drejtoria, Koagulatorët dhe Filtrat.

Gjatë tremujorit të parë në njësinë e Prizrenit janë realizuar këto aktivitete: Janë përpiluar Raportet për muajin dhjetor, raporti vjetor për vitin 2018 - TM 4/2018, (raportet për muajt janar, shkurt dhe mars 2019), gjithashtu janë bërë edhe oraret e punës për janar, shkurt dhe mars/2019 dhe është bërë shpërndarja e tyre në të gjitha objektet të cilat kujdestarohen gjatë 24h në Prizren.

Gjithashtu gjatë çdo fund jave është pranuar Njoftimi, se kush do të jetë kujdestar gjatë gjithë javës dhe gjatë çdo fund jave është bërë shpërndarja e tyre në çdo objekt ku kujdestarohet 24 h nga Rojet.



Në objektin e burimeve “40 Burime”, është rrafshuar pjesën për rreth rrugës, ku edhe janë mbjellur fidanet.

Si punë me vlerë të veçantë gjatë këtij tre mujori të parë për vitin 2019, mundë ta konsiderojmë pastrimin e Koagulatorëve nga punonjësit roje të kompanisë. Propozojë që njësitë operativ të intervenojnë në pjesën ku mblidhet uji , të betonohet një shtresë në pjesën e poshtme të rezervuarit, sepse ka të qara po thuajse i gjithë rezervuari, dhe koagulatorët të ngjyrosen.

Vizitë është bërë edhe objektit të sapo ndërtuar , “Rezervuari i ri”, i cili gjendet sipër objektit “Shpati”, ku parashihet që ky rezervuar ti shërbejë me ujë të pijes lagjet Janina dhe Dardania.

Vizitat (kontroll) objekteve të Kompanisë janë zhvilluar edhe në fshatrat për rreth qytetit të Prizrenit si në : Zhur, Nashec (sozi), Gjonaj, Kushnin, Kojush dhe Sërbic.

Mamushë – vizit në objektin apo rezervuarin e ujit, i cili gjendet në pjesën kodrinore të Mamushës, objekti në fjalë i plotëson kushtet minimale të sigurisë së ujit.

Në vazhdimësi janë kryer vizita në të gjitha objektet e njësive punuese në zonën e shërbimit dhe për gjendjen e tyre janë njoftuar me shënim zyrtar udhëheqësit e shërbimeve përkatëse të kompanisë dhe se kujdestaret – roje pas çdo vizite që kemi bërë kanë qenë në vendin e punës.

### **Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për janar - mars 2019**

Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

Ndërhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 78 herë.

Ndërhyrje në Komune – Malisheve: 45 here

Ndërhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 94 herë.

Ndërhyrje në Komune – Suhareke: 44 here.

Ndërhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 28 herë.

Ndërhyrje në njësinë Shatërvan: 48 herë.

Ndërhyrje në njësinë Depo: 12 herë.

Ndërhyrje në njësinë Filtrat: 72 herë.

Ndërhyrje në Komunë - Prizren: 80 herë.

Ndërhyrje në Ueb Faqe 40 herë; Njoftime për konsumatore, gjithsejtë 22, ngarkim i dokumenteve (konkurseve) 18.

Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 802 herë.

Përkujdesje për qasjen e Kompanisë në rrjetin e internetit.

Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.

Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.

Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të Kompanisë.

Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.

Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.

Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.

Rregullim rrjeti në Filtra, (Problem me IPKO).

Rregullim i Fotokopjes 4110 në Prizren nga MIRI XEROX, në vlerë 160 Euro.

Perkujdesje për mbarevajtjen e shtypjes së faturave.

Perkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve. Serveri Databaze, GIS, DNS.

Perkujdesje për garancionet e paisjeve dhe dergimin e paisjeve të amortizuara për asgjësim në Depo.

Perkujdesje në hapjen e përdoruesve të rinjë në Baze dhe Njësi.

Perkujdesje për shënimin dhe organizimin e furnizimit të paisjeve nga furnitori

Konfigurim i modemit të postës.

Ndihmë në shtypjen e faturave në Baze dhe njësi.

Rregullim rrjeti në Filtra, ndërrim i modemit.

Rregullim i shtypjes së verejtjeve në zyrën e shefit të inkasanteve.

Hapje e përdoruesve të rinjë në NAV dhe Billing.

Krijim i PPTP Userëve për kyqjen nga larg.

Marrje e pjeseve funksionale nga Kompjuteret e vjeter (te djegur ne pllake), e qe ishin te pa aftesueshem dhe pjeset e vjetra i kemi dergu per ç' regjistrim ne Depo. Ketu kemi perfshire (Printer, Kompjutere, Ups).

## **PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS**

Vazhdojnë te jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë ku disa lëndë kanë bëjnë me kontest nga marrëdhënia e punës ndërsa njëra me kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit.

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç' rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përmbarimi i lëndës përmbaruesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbarim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbarim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbarimit bien mbi kompaninë.

Probleme na paraqesin edhe rastet kur edhe pse konsumatori është shkyçur, faturimi vazhdon, dhe me këtë dëmtohet konsumatori por edhe kompania, sepse ne ngarkohemi me TVSH dhe njëkohësisht me veprime të tilla dëmtohet edhe imazhi i kompanisë.

## **Propozim për zgjidhjen e problemeve**

Sipas Zyrës Ligjore për tu zgjidhur problemet e lartcekura, nevojitet angazhim i të gjithë punonjësve dhe në veçanti angazhimi i lexuesve pasi që janë në kontakte të rregullta me konsumatorët, ku faktori kryesor përgjegjës për ti ikur parashkrimit të borxheve ndaj kompanisë do të ishte që të njëjtët të i bindin konsumatorët të paktën një pagesë nga borxhi i krijuar brenda vitit kalendarik nga konsumatori, ndërsa sa i përket eliminimit të problemit lidhur me konsumatorët e vdekur, ne

propozojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte shkyçja nga rrjeti i ujësjellësit nëse pasardhësi nuk pranon të kaloj borxhi në emër të tij.

#### **PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK**

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM4-2018, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbarim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

#### **SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV**

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja;

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

## **LËNDA: Raporti tremujor (TM1/2019) i punës së auditorit të brendshëm.**

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezentimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të cilat janë realizuar gjatë tremujorit të parë të këtij viti, gjegjësisht raport i punës për periudhën kohore janar – mars 2019.

- Fillimisht, gjatë kësaj periudhe është përgatitur raporti vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin paraprak 2018.

Në këtë raport në formë të përgjithësuar dhe kronologjike është bërë prezentimi i punës njëvjeçare, lidhur me të gjitha auditimet e realizuara, subjektet ku janë realizuar auditimet, prezentimi i të gjitha konstatimeve, të gjeturave, rekomandimeve, komenteve, rishikimin e rekomandimeve të dhëna, si dhe nivelin e adresimit të rekomandimeve.

Raporti në fjalë është shqyrtuar, diskutuar dhe është aprovuar nga Komisioni i Auditimit.

- Është përgatitur raporti i tremujorit të katërt (TM4/2018) i punës së auditorit të brendshëm, përmes të cilit është bërë një përmbledhje e punëve dhe aktiviteteve kryesore të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018, gjegjësisht periudhës kohore tetor – dhjetor 2018.

- Në pajtim me planin vjetor të punës si dhe auditimit me kërkesë të Komisionit të Auditimit, janë realizuar disa auditime, sikurse:

- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të pasurisë,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të të hyrave,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të pagave të punonjësve,
- Fillimi i auditimit lidhur me menaxhimin e procesit të shpenzimeve rrjedhëse, si dhe
- Gjatë muajit mars kam qenë intenzivisht i anagazhuar me auditorët e ZKA lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë për vitin 2018.

- Pas përfundimit të auditimeve, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë:

- përgatitja e draftraporteve,
- mbajtja e takimeve me subjektet e audituara,
- diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe
- finalizimi i raporteve (në përjashtim të draftit të auditimit të shpenzimeve).

- Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimeve të kësaj periudhe tremujore, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve dhe zhvillimi i procedurave në Hidroregjionin Jugor, është kryer:

- në pajtim me dispozitat ligjore,
- është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe
- është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

- Gjatë auditimit të disa proceseve, janë konstatuar edhe mangësi, ku dhe është dhënë rekomandime të cilat edhe priten të realizohen.

- Në vazhdim, në përjashtim të raportit vjetor të punës për vitin 2017, raport i cili është shqyrtuar në takimin e Komisionit të Auditimit, në këtë raport, në mënyrë kronologjike sipas auditimeve të kryera, janë prezentuar konstatimet, të gjeturat, konkluzionet, rekomandimet, dhe komentet e tyre.

#### 1. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të pasurisë

Gjatë auditimit lidhur me procesin e menaxhimit të pasurisë në KRU Hidroregjioni Jugor, konkretisht të pasurive joqarkulluese, sikurse është prona, impiantet dhe pajisjet, është konstatuar se në përgjithësi procesi është menaxhuar mire, është zhvilluar në pajtim me ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave nr.05/L-029, ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, SNK16 dhe SNK36, si dhe Rregulloren e Brendshme për Menaxhimin e Aseteve nr.01-36/02, të datës 30.07.2018.

- Është konstatuar se vlera e asetëve me 31.12.2018 është 19,626,668.01 euro, ndërsa zhvlerësimi i akumuluar është 1,239,299.00 €. Shuma totale e pasurive të realizuara gjatë vitit 2018 ka qenë 2,985,584.49 €, ku prej tyre asete në shumë prej 285,336.81 euro, ndërsa investimet në vijim në shumë prej 2,700,247.68€.

- Është konstatuar, se është vepruar në pajtim me ligjin nr.05/L-029 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, neni 18, ku parashihen kushtet, lidhur me shumën e shpenzuara për riparime ose përmirësime të një aseti, që të mund të kapitalizohen dhe t'i shtohen bazës së asetëve. Obligim ligjor është që riparimet ose përmirësimet të tejkalojnë jetën e përdorimit të asetit për së paku 1 vit, si dhe shuma e riparimit apo përmirësimit të jetë më e madhe se 1,000 €.

Duhet theksuar, që edhe pse ka pasur rast kur nuk janë përmbushur dy kriteret e kërkuara me ligj, sikurse rasti furnizimit apo riparimit të automjetit në shumë prej 788.14 € (fatura nr.00607/2018, e furnitorit NTSH "Krasniqi), megjithatë bazuar në natyrën e shpenzimit, si dhe parimit që ka të bëjë me zgjatjen e jetëgjatësisë së asetit, konsideroj se është vepruar në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht Udh.Adm.të Ministrisë së Financave nr.02/2016.

- Është konstatuar se vënia për herë të parë e një pasurie gjegjësisht një aseti në funksion, është realizuar në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK 16 dhe SNK 36), me ç'rast regjistrimi bëhet sipas kostonë së tij gjegjësisht çmimit të blerjes, duke ia zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmit.

- Është konstatuar se zhvlerësimi i pasurisë (përpos tokës), bëhet sipas metodës lineare apo drejtëvizore, në fund të periudhës tatimore, sipas kategorive që i përkasin asetet. Asetet e kategorisë I, sikurse ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore zhvlerësohen me 5%, ndërsa asetet e kategorisë II, veturat, kamionët, kompjuterët dhe pajisjet për zyre, zhvlerësohen me 20%.

- Është konstatuar se regjistrat kontabël të pasurive ku bëhet regjistrimi, zhvlerësimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të përgjithshëm të pasurive, janë në pajtim me ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03-L/048, neni 43.3.

Duhet theksuar se këto procese, në kompani mbahet në modulën e veçantë të asetëve (Navission), si dhe në sistemin e kontabilitetit (Piano), ku dhe me rëndësi është se të dhënat janë të barazuara.

- Gjatë auditimit, në bazë të mostrave, në përjashtim të investimeve në vijim të cilat dhe mbeten të rishikohen me rastin e përfundimit të tyre, është bërë shqyrtimi i dokumentacionit të pasurisë në baza analitike, të realizuara nga mjetet vetanake si dhe nga donatorët.

Nga totali i pasurive të vitit 2018 që janë në shumë prej 285,336.81 €, prej tyre 272.516.61€ janë nga mjetet vetanake, ndërsa 12,336.20€ janë nga mjetet e donatorëve.

- Është konstatuar se në përgjithësi, procesi është realizuar në pajtim me Rregulloren e Brendshme për Menaxhimin e Aseteve 01-36/02, neni 11.2, ku kërkohet dhe parashihen fazat e realizimit të projektit, sikurse: kërkesa për realizimin e projektit, paramasa – paralogaria e projektit, caktimi i menaxheri të projektit, urdhëresat për materialin nga depoja, faturat nga furnitori, punimet shtesë, libri ndërtimor si dhe procesverbali i pranimit teknik.

E gjetura: Përkundër kësaj, gjatë testimit të regjistrimit të projekteve investive, në këtë rast atyre në vijim, është vërejtur një mangësi, gjegjësisht realizimi i projekteve jashtë planit vjetor të paraparë me plan biznes të kompanisë për vitin 2018. Rasti i projektit të ndërtimit të rrjetit të ujit për Komunën e Mamushës, që është në shumë prej rreth 213,022.56 euro.

Konkluzion: Edhe pse mangësia në fjalë, mund të jetë si pasojë e posedimit jo të plotë të dokumentacionit nga ana e zyrtarit të aseteve, apo edhe kërkesave emergjente të paraqitura, konsideroj se pa një analizë të duhur, dhe pa sigurimin e fondeve, realizimi i projekteve të tilla mund të ndikoj në implikime buxhetore si dhe pezullimin e projekteve të planifikuara.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri financiar, që në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë, t'i ofrojnë zyrtarit përgjegjës për aseteve të dhëna dhe dokumentacion të plotë, për furnizimet dhe projektet e realizuara si dhe atyre në vijim, në mënyrë që ketë një kronologji ma të saktë të tyre në regjistrin e aseteve.

Njëherit, rekomandoj që gjatë realizimit të investimeve, të respektohet plani i biznesit, dhe të mos ketë devijime të planit si dhe hyrje në detyrime tjera.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë, do të anqazhohemi në zbatimin e rekomandimit.

- Është konstatuar se gjatë janarit të vitit 2019, në pajtim me kërkesat ligjore, përmes komisioneve të caktuara me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, është kryer procesi i regjistrimit apo inventarizimit të pasurisë së kompanisë për vitin 2018. Në bazë të raportit të komisionit të regjistrimit si dhe të komisionit qëndror është konstatuar se gjendja faktike e pasurisë është e barazuar me gjendjen në kontabilitet.

## 2. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të të hyrave

Gjatë auditimit lidhur me menaxhimin e procesit të të hyrave të vitit 2018, është konstatuar se procesi në fjalë është menaxhuar mirë, është vepruar në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe ligjet e aplikueshme, poashtu është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

- Është konstatuar se shuma e përgjithshme e të hyrave për vitin 2018 është 4,367,126.55 euro. Prej tyre, 4,294,313.84 euro janë të hyra nga uji, kanalizimi dhe tarifa fikse, ndërsa 72,812.71 euro janë të hyra nga taksat dhe shërbimet tjera.

- Është konstatuar se procesi i regjistrimit të tyre në sistem të faturimit, në kontabilitet, si dhe prezentimi i tyre në draft pasqyrat financiare të vitit 2018, është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, gjegjësisht SNK me nr.1.25 dhe SNK nr.18.22. Sipas SNK nr.1.25, që ka të bëj me Paraqitjen e Pasqyrave Financiare, kërkohet që kompania duhet të përgatis pasqyrat financiare duke përdorur kontabilitetin aktual.

*Sipas kësaj baze, efektet e ngjarjeve njihen kur ato ndodhin dhe jo kur arkëtohen, ndërsa regjistrohen dhe raportohen në pasqyra financiare të periudhave në të cilat kanë ndodhur.*

Ndërsa, sipas SNK nr.18.22, që ka të bëj me Të Hyrat, kërkohet që të hyrat të njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike që kanë të bëjnë me transaksionin do të hyjnë në entitet. Megjithatë, kur shfaqet pasiguri lidhur me arkëtueshmërinë e një shume tashmë të përfshirë në të hyrat, shuma e pa-mbledhshme ose shuma për të cilën nuk është më i mundur arkëtimi, duhet të njihet si një shpenzim dhe jo si një korrigjim i shumës së të hyrës së njohur më parë.

- Është konstatuar se gjatë faturimit të konsumatorëve, është vepruar në pajtim me Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar me nr.05/L-037, neni 1 dhe neni 2.2.1, lidhur me përlogaritjen rreth obligimit të tvsh-së së llogaritur (konto nr.4610 dhe nr.4611) të konsumatorëve, sipas shkallëve dhe normave të lejuara (normës 8% dhe 18%).

E gjetura: Gjatë auditimit është bërë shqyrtimi dhe testimi i të hyrave të prezentuara në draft pasqyrat financiare, si dhe krahasimi i tyre me të hyrat sipas raportit të performancave të kompanisë. Me këtë rast është konstatuar një diferencë e vogël, nga 4,367,126.55€ që janë draft pasqyra, ndërsa 4,366,867.17€ sipas raportit të performancës.

Konkluzion: *Diferenca në mes të këtyre dy raporteve është mjaft e vogël -259.37€, si rezultat i procesit të azhurnimit të të dhënave të TM3 dhe TM4, megjithatë mund të ndikoj në besueshmërinë e raportimeve zyrtare.*

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri financiar që të kërkoj nga shërbimi i kontabilitetit, që ndryshimet e konstatuara të përmirësohen, meqë një raport i tillë ende nuk është finalizuar dhe nuk i është dërguar institucioneve gjegjëse, sikurse NjPMNP, ARRU-së, etj.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Diferenca është rezultat i azhurnimit të të dhënave me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare 2018.

- Gjatë auditimit, është bërë krahasimi i të hyrave të realizuara gjatë vitit 2018 me të hyrat e njëjta gjatë vitit 2017. Është konstatuar se gjatë këtij viti, në përjashtim të rënies së të hyrave në disa kategori, sikurse te të hyrat nga uji në institucione dhe te tarifa fikse, për shkak të uljes së tarifës gjatë këtij viti, në përgjithësi marrë në total ka pasur rritje të të hyrave në shumë prej **106,585.93 euro apo për 2.50%**. Nga totali i të hyrave prej **4,260,540.62€**, sa ishte në vitin 2017, totali i të hyrave gjatë vitit 2018 është **4,367,126.55€**.

E gjetura: Edhe pse realisht trendi i të hyrave është në rritje, megjithatë është vërejtur se realizimi i cakut të paraparë me plan biznes të vitit 2018, nuk është realizuar. Sipas plan biznesit 2018, shuma e planifikuar e të hyrave ishte 4,757,898.09 euro, që bazuar në këtë, faturimi është më i ultë për 390,771.54 € apo për 8.22%.

Konkluzion: *Konsideroj se niveli jo i kënaqshëm i faturimit, mund të jetë për arsye të ndryshme, të cilat nuk dua t'i përsëris meqë ato janë raportuar në mënyrë më analitike në raportin e auditimit të*



*realizuar në shërbimin me konsumatorë, mirëpo një ndër shkaqet është procesi jo korrekt i leximit nga ana e shërbimeve gjegjëse. Fakt është niveli i lartë i faturimit të konsumatorëve me tarifë fikse, që sipas të dhënave të muajit 12/2018, faturimit me paushall në nivel të kompanisë është për 3 kategoritë e konsumatorëve të marrë mostër, sikurse ata të amvisërisë, bizneseve dhe institucioneve është 36.21% (me detajisht shih tabelën në vijim).*

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri financiar, që në bashkëpunim me shërbimin me konsumatorë, nga të gjitha Njësitë Punuese të kërkoj një përkushtim më të madh, dhe të marrin masa në drejtim të rritjes së të hyrave të përgjithshme, njëherit edhe të përmbushjes së planit të biznesit të kompanisë.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë, do të angazhohemi që të realizojmë parashikimet sipas planit të biznesit.

### 3. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të pagave të punonjësve

- Është konstatuar se caktimi i pagës bazë për të punësuarit e kompanisë, bëhet në bazë të sistematizimit të vendeve të punës. Paga bazë shprehet në koeficientë, ku vlera është 75 €, të kategorizuar në 17 grupe.

- Është konstatuar se përgatitja dhe azhurnimi i regjistrit të pagave, bëhet nga departamenti i administratës dhe personelit, i cili në bazë të kontratave të punës dhe vendimeve të brendshme, bën futjen e të dhënave në sistem, e që pastaj regjistri dërgohet në shërbimin e financave për procesim.

Përveq pagës bazë, në pagën bruto përsihet edhe pagesa e shujtës, stazhit të punës, puna jashtë orarit, stimulimet etj, të gjitha këto të mbështetura me vendime interne si dhe Ligjin e Punës me nr.03/L-212.

- Është konstatuar se kontrollimi dhe aprovimi i listave të pagave për ekzekutim, bëhet nga menaxheri financiar dhe kryeshefi ekzekutiv i kompanisë.

- Është konstatuar se shpenzimi i pagave gjatë muajit 12/2018 për gjithsej 333 punëtorët aktual (6 prej tyre janë anëtarë të B.D), është në shumë prej 179,451.60€.

- Është konstatuar se shuma e shpenzimeve të pagave për vitin 2018 është në shumë prej 2,070,065.60 euro, me çrast është konstatuar se shuma në fjalë, është në pajtim me shumën e planifikuar për këtë kategori të shpenzimeve, të paraparë me plan biznes të kompanisë për vitin 2018, që është prej 2,317,542.05 euro.

- Është me rëndësi të theksohet se me iniciativë të menaxhmentit të kompanisë dhe përkrahje të Bordit të Drejtorëve gjegjësisht të Komisionit të Auditimit, qysh në vitin 2017, përmes komisionit të veçantë kishte filluar procesi i nivelizimit të pagave.

Është konstatuar se në bazë të mandatit të komisionit, ishte përgatitur platformë ose program mbi të cilën do të punohej në këtë proces, dhe si parim për caktim të koeficientit ka qenë, citoj “për pozitë të njëjtë, përgatitje profesionale të njëjtë, përgjegjësia e njëjtë, vëllimi i punës i njëjtë, kompenzimi i njëjtë”.

Megjithatë, gjatë punës së komisionit, nga menaxherët kishte edhe mendime dhe propozime të ndryshme për koeficientë, ku sipas komisionit ishte vërejtur tendenca për rritje të koeficientëve dhe jo nivelizimit të tyre. Si pasojë, gjatë vitit 2018, nga 17 kategoritë e koeficientëve apo nga 3 grupet e caktuara, është kryer vetëm nivelizimi i pagave për grupin e I –rë, të atyre atyre me koeficient më të ultë.

- Është konstatuar se menaxhmenti i lartë, poashtu edhe B.D vazhdimisht ka kërkuar që ky proces të përfundohet, duke kërkuar gjithashtu, që të formohet edhe komision tjetër për të shqyrtuar koeficientët e pozitivave të nivelit menaxherial.

Gjithashtu, në kontekst të përfundimit sa më parë të këtij procesi të zgjatur, B.D, edhe pse jo në mënyrë decisive, megjithatë kishte propozuar që gjatë punës së komisionit rreth nivelizimit të merren në konsideratë implikimet buxhetore që të mos tejkalohet urdhëresa tarifore (procesv. i takimit të BD/ 30.07.2018).

- Është konstatuar se në bazë të kërkesave të vazhdueshme, menaxheri financiar, kishte marrë në shqyrtim propozimet, arsyeshmërinë e kërkesave të menaxhmentit, dhe përmes një raporti të paraqitur në takim me menaxhmentin (nr.prot.123, datë 18.01.2019), ka sqaruar dhe ka siguruar se ekzistojnë mundësi financiare për mbulimin e kostos së procesit të nivelizimit dhe ngritjes së shumës së koeficientëve.

Të përfshirë në këtë raport, kanë qenë gjithsejt 42 të punësuar, me pozita të niveleve të ndryshme, nga punëtorët fizik e deri te niveli menaxherial. Rritja është për 29.2 koeficientë, dhe kostoja mujore është 2,190€ në muaj, apo 26,280 në vit.

- Është konstatuar se përmes një raporti tjetër me shkrim të menaxherit financiar (nr.prot.122, datë 18.01.2019), të raportuar para menaxhmentit, është vlerësuar se kompania ka mundësi financiare për rritje lineare të vlerës së koeficientit për 10 euro, nga 75€ në 85€. Sipas kësaj përlllogaritje, e cila është bërë gjatë muajit 12/2018, duke përfshirë edhe rritjen e 29.2 koeficientëve, shuma vjetore do të ishte 2,505,300.00 €, shumë kjo që është në kuadër të plan biznesit për vitin 2019, që është 2,509,591.10 euro.

Konsideroj se shuma në fjalë, mund të jetë edhe më e ultë, me supozimin që të vazhdohet me këtë numër të stafit prej 333 dhe sipas shpenzimeve të muajit 02/2019.

Bazuar në raportin detal të menaxherit financiar, gjatë takimit të menaxhmentit të mbajtur me datë 18.01.2019, pas një diskutimi dhe shqyrtimi të gjendjes, në mënyrë unanime, nga të gjithë menaxherët dhe udhëheqësit, është votuar pro këtij propozimi. Mbi këtë bazë, K.E ka nxjerrë vendim me shkrim (22.01.2019, nr.prot.151), për aprovimin dhe futjen në fuqi të propozimit për rritjen e koeficientëve dhe rritjen e vlerës së koeficientit.

E gjetura: Në bazë të përshkrimit kronologjik të procesit të audituar, në bazë të testimëve të dokumentacionit, por dhe bisedave të zhvilluara me menaxhmentin e lartë, duhet theksuar se procesi i nivelizimit të pagave, është proces mjaft i ndërlikuar, dhe pa marrë parasysh kriteret e mirë përcaktuara, është vështirë të realizohet. Problemi qëndron tek fakti se kompania e ka trashëguar një situatë dhe strukturë të tillë të punësuarëve, si nga aspekti i përgatitjes së tyre shkollore dhe profesionale. Poashtu, edhe pse secila pozitë e punës mund të duket lehtë e definuar, megjithatë përbën një fushë mjaft komplekse.

Bazuar në të gjitha këto vështirësi, konsideroj se procesi nuk është realizuar në tërësi, dhe ende ka diferenca mes pozitivave dhe përgjegjësi që kanë të punësuarit.

Konkluzion: Pa marrë parasysh mangësitë që ka procesi në fjalë, megjithatë jemi dëshmitarë se gjatë muajve të kaluar, vendi është ballafaquar me greva nga punëtorët e të gjitha niveleve shtetërore. Me këtë, konsideroj, që ka pasur mundësi, që kjo situatë të reflektoj edhe tek ne si kompani, meqë dihet mirëfilli se në kompani, me vite të tëra nuk ka pasur rritje të pagave. Andaj, vonesat rreth implementimit të kërkesës për nivelizim të pagave, e që tek punëtorët është kuptuar dhe pritur si rritje e pagave, edhe përkundër mangësive që ka procesi i realizuar, konsideroj se ka qenë i domosdoshëm. Gjithashtu konsideroj, se çdo ndryshim eventual, apo kthim prapa i procesit, mund të bartë me vete edhe përgjegjësit por edhe konsekuencat.

Rekomandim: Rekomandoj menaxhmenti i lartë i kompanisë, që të rishikoj procesin e papërfunduar të pagave të punonjësve, si dhe të mirren për bazë përmirësimet dhe plotësimet e nevojshme, të bazuara në parimet dhe rregullat e brendshme, si dhe bazuar në sistematizimin e vendeve të punës. Gjithnjë duke pasur kujdes në nivelin e shpenzimeve të buxhetuara dhe të miratuara nga organet kompetente.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë, brenda periudhës qjashtëmuajore, planifikohet të përfundohet procesi në fjalë.

## **Programi mbështetës për ujë dhe kanalizim faza e V-të dhe VI-të**

**Investitor : Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Zvicrës**

**Implemetuesit e Programit : Firma Gjermane “ Dorsch “ dhe Firma Vendore “ CDI “**

**Raporti :**

**Progresin e Programit : faza e V-të dhe Vazhdimi i fazës së VI -të**

**Raporti i punimeve : Punimet ne ndërtimin e sistemit te ujësjellsave në Malisheve dhe Suharejkë**

\*Punimet për: “Ndërtimi i Sistemit për Furnizim me Ujë të Pijshëm për 13 (trembëdhjetë) Fshatra në Komunën e Malishevës.”

Deri me tani kompania “Hidro Project” ka përfunduar punimet e rrjetit të ujësjellsit - Rrjetin Primar dhe sekondar rreth 89.500m’ , gjithashtu kane përfundur ndërtimet e gjashte rezervareve.

Ne ne vitin 2018 dinamika e punimeve ka qene me e ngadalshme pershkak te pronave private ku eshte paraparë të kalon rrjeti i ujësjellsit dhe pergjat rruges Magjistrale Peje -Prishtine , Per te përfunduar komplet rrjetin e ujësjellsit për 13 fshatra t e Malisheves duhen të kemi edhe 7000 metra gypa ( Fi -200 = 3900metra ; fi 140=3100 metra ) PE -100, Pn=10 barë .

Jemi ne pritje të furnizimit me gypa nga implemetuesi: Dorsch&CDI qe të na furnizon me gypa

\*Punimet në ndërtimin e sistemit te ujësjellësave në Komunën e Suharekës janë duke vazhduar, Ne fshtin Dubravë dhe te Rezervari ne Baqec ( Izolimi i Jashtem ).

Vazhdohet me monitorimin e humbjeve ne zonat e izoluar të humbjeve dhe intervenime po kan sukses ne zvoglimin e humbjeve .

\*Faza e VI-te ; jane duke u kryer studime ne Zona te caktuara , Pizren –Pjesa e Hasit , Burimi i Sozit , Janë bere kontrolla ;Rezervareve , Linjave , Kontrolla e Konsumatoreve per humbjet e ujit

-Zonat e Humbjes se ujit Ne Suharekë , Malisheve , Prizren  
 -Trajrtimi i ujrave të zeza , ne K.Komunal Suharekë, fshatin Bukosh  
 Sistemet e reja te ujesjellesit; ne Komunen e Suharekes – fshatrat 1/Maqiteve ; 2/Neprebisht  
 Komunen e Prizrenit ; Fshati Landovicë, Laxheja e Janines  
 Ne Komunen e Dragashit ; Ndertimin e fabrikes per perpunuimin e ujit nga Radesha  
 Jemi ne pritje te shpalljes se tenderimit për këto punime

### **Sfidat**

Gjate vitit 2018 saktesisht gjate punimeve ne fshatrat Senik dhe Lladrov kemi pasur nderprerje te punimeve disa here nga banoren të cilet nuk lejojne te kalohet me gyp ne parcelat private te tyre ,gjithashtu ne fshatin Terpeze pasi e kemi instaluar gypin e ujesjellesit Ø315 pronari i parces na ka urdheruar te behet zhvendosja e gypin ne nje gjatesi prej 200m' .

Gjithashtu kemi pasur nderprerje pergjate segmentit te rruges Peje-Prishtine jemi detyrur te punojme her ne nje segment her ne nje tjetër .

Jemi duke punuar me kapacitet maksimal per perfundimin e projektit ne fjale mirepo problemet pronsore jane faktoret te cilen kane shkaktuar vonesa ne plan dinamik .

Punimet vazhdojne në disa segmente apo edhe ne finalizimin e nyjeve njekoheisht me qellim qe ky projekt te perfundoje ne periudhe sa me te shkurter.

Vonesat e pagesave nga ana e Implementuesit te Programit ( CDi – Dor

### AKTIVITETET E PROKURIMIT PER VITIN FISKAL 2019

Nr.	Vetanake 1/ Donacion2	Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Nr.i Prokurimit	Data e nenshkrimt	Vlera e kontrates	Operatori Ekonomik	Vrejtje	Data e skadimit
1	1	Ritender –Furnizim me goma	HJ/18-012-121	28.01.2019	43,691.60€	Auto Buqa		
2		Retender-Furnizim dhe montim i LPP dhe trafostacionit 160kw	HJ/18-020-121	24.01.2019	12,300.00€	“V3-ING”		
3		Instalimi dhe Funkcionalizimi softverik i hardverik i leximit mobil dhe krijimi i faturimit te bazuar ne ueb ne kuader te sistemit informative te Kompanise	HJ/18-023-121	04.04.2019	75,489.32€	“PBC” SHPK		Perfundon 60dite nga nga data e kerkeses
4		Furnizim me elektro pompa zhytесе 22kw	HJ/18-024-136	21.01.2019	3,900.00€	Npt “Linda”		Perfundon 30dite nga nga data e kerkeses
5		Retender-Sigurimi i Automjeteve	HJ/19-001-236				Ne procedur	
6		Furnizim me zorre te gomes per cisterne kanalizimi c1 250bar	HJ/19-002-136	25.02.2019	2,688.00€	NPT “Bojku Hidraulik”		25.03.2019
7		Furnizim me material per pune	HJ/19-003-121	11.04.2019	98,792.46€	SHPK “Hidro Bau”		11.04.2022
8		Hulumtimi i knaqshmerise se konsumatoreve ne zonen e sherbimit per periuhен janardhjetor 2018 ne zonen e sherbimit te cilen e mbulon KRU “Hidroregjioni Jugore”	HJ/19-004-236	25.02.2019	1,449.00€	SHPK “Global Consulting Development Associates”		25.03.2019
9		Ritender-Furnizim me 3 Hidropompa	HJ/19-005-136	15.04.2019	5,200.00€	Npt “Linda”		Perfundon 15 dite nga nga

								data e kerkeses
10		Furnizim me elektro pompa zhytесе	HJ/19-006-121					Ne procedur
11		Servesimi i automjeteve zyrtare	HJ/19-007-221					Ne procedur
12		Furnizim me pompa(Kornize)	HJ/19-008-111					Ne procedur
13		Furnizim me paisje per detektim te parave falso(kartmonedhave dhe kuinsave-monedha metalike)	HJ/19-009-136	25.03.2019	4,740.00€	NTSH “Treo Electronics”		Perfundon 20dite nga nga data e kerkeses
14		Furnizim me material per zyre	HJ/19-010-121					Ne procedur
15		LOT I:Kerkese per Dozator te Klorit(me Hipokoklorur te Natriumit) LOT II:Paisje per Dezinfektim dhe pjese rezerve	HJ/19-011-121	19.04.2019	LOT I:17,233.00 €  LOT II:3,648.00€	NPT “Avesta”		Perfundon 30dite nga nga data e kerkeses

Ky raport pasqyron punen ne zyrën e prokurimit te KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a Prizren dhe ecurite e procedurave per tre mujorin e pare te vitit 2019

Gjate tre mujorit te ketij viti ne zyrën e prokurimit jane zhvilluar keto aktivitete te prokurimit:

Këtij dokumenti i është bashkangjitur si aneks të gjitha llojet e kontratave të nënshkruara deri më sot me operatorët ekonomik si dhe aktivitet qe jane ne procedur.

